



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr: 03-111/01-9676
Datë: 24.02.2026

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE

Bazuar ne nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës

Dy (2) Infermier/re në Njësin e Urgjences-QKMF-Lipjan

1. Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Infermier/e në Njësinë e Urgjencës është përgjegjës/e për ofrimin e kujdesit infermieror emergjent, vlerësimin e shpejtë të pacientëve në gjendje urgjente, asistimin në procedura urgjente mjekësore dhe transportin e pacientëve në mënyrë të sigurt dhe profesionale me autoambulancë, sipas protokolleve dhe udhëzimeve zyrtare të qendrës dhe legjislacionit në fuqi.

2. Vlerësimi dhe kujdesi emergjent

Kryen marrjen e historisë mjekësore emergjente dhe vlerësimin fillestar të pacientit (shenjat vitale, niveli i vetëdijes, gjendja respiratore, gjendja kardiovaskulare).

Monitoron dhe regjistron shenjat vitale dhe ndryshimet e gjendjes klinike të pacientit.

Identifikon dhe prioritetizon rastet urgjente sipas protokolleve të triagjimit (triage).

Ofron kujdes infermieror emergjent në përputhje me standardet profesionale dhe protokollin klinike.

3 Procedurat dhe menaxhimi klinik

Vendos linja venoze periferike dhe administron tretësira, barna dhe oksigjen sipas indikacioneve dhe urdhrave mjekësorë.

Asiston mjekun në procedura emergjente si reanimim kardiopulmonar (CPR), imobilizim të frakturave, trajtime të plagëve, etj.

Përdor pajisje emergjente (defibrilator, monitor shenjash vitale, oksigjenator) sipas nevojës dhe në përputhje me protokollin e përdorimit.

4. Transporti me autoambulancë

Siguron përgatitjen dhe stabilizimin e pacientit për transport.

Vozit autoambulancën në mënyrë të sigurt dhe profesionale, duke respektuar rregullat e komunikacionit dhe kodet e urgjencës.

Siguron monitorim të vazhdueshëm të pacientit gjatë transportit.

Komunikon me stacionet tjera mjekësore për situatën klinike të pacientit gjatë transportit.

Kujdeset për mirëmbajtjen bazike të autoambulancës, kontrollon pajisjet dhe materialin mjekësor para dhe pas çdo transporti.

5. Dokumentimi dhe komunikimi

Plotëson në mënyrë të saktë dhe të qartë të gjithë dokumentacionin mjekësor dhe infermieror të rasteve të trajtuara.

Regjistron çdo intervenim urgjent, medikament të administruar, transport dhe komunikim me qendrën mjekësore ose mjekun përgjegjës.

Komunikon qartë dhe profesionalisht me pacientët, familjarët e tyre dhe ekipin mjekësor.

Standardet profesionale dhe trajnimi

Respekton dhe zbatojnë protokollet klinike, standardet etike dhe rregulloret ligjore në fuqi.

Merr pjesë në trajnime, seminare dhe aktivitete të zhvillimit profesional të kërkuara nga institucionet përkatëse.

Mbështet proceset e auditimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë brenda QKMF-Lipjan.

6. Raportimi organizativ

Infermier/e në Urgjencë raporton direkt te Kordinatori/Administratori i Shërbimit të Urgjencës së QKMF-Lipjan dhe bashkëpunon me mjekun kujdestar, ekipet tjera mjekësore dhe autoritetet relevante.

Kushtet dhe kriteret:

- Fakulteti Baçelor i Shkencave në Infermieri – Drejtimi i Përgjithshëm.
- Licenca e Punës (me afat)
- Certifikata Shëndetësore (jo ma e vjetër se gjashtë muaj)
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan (jo ma vjetër se gjashtë muaj)
- Kopja e Letërnjoftimi (me afat).
- Kopje e patet shoferit kategorija **B** (me afat)

Aftësitë:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur dhe në grupe duke respektuar ligjet si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnike apo religjioni.

Paga mujore:

Koeficienti: (grupi H klasa H17 koeficienti 6.4)

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar

Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data **24.02/2026** deri **25.03/2026** që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Kandidatet të cilet kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur(nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje,(të noterizuara Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**



Drejtori i DSHPS-së
Shkelzen Hajdini